



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.216/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli, në lëndën penale kundër të pandehurës A. M., nga P., e akuzuar për veprën penale *lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par.4 të KPRK-së*, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.101/16 të datës 08.03.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 07.02.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sanije Gashi Seferi dhe të pandehurës A. M, me datë 07.02.2018 murr dhe publikisht shpalli, dhe të njëjtën ditë e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura A.M, e lindur me datë 11.07.1997, në fsh.Q K.R, tani me vendbanim në P., në rrugën e B, nr..., e bija M dhe nënës H e vajzërisë G, me numër personal, ka të kryer shkollën mesme, e pa punë, e pa martuar, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTORE

Për shkak se:

Me dt. 05.01.2016 rreth orës 17.00, në Pejë, bën lajmërimin të rremë, në atë mënyrë që e pandehura pasi që kishte dal nga shtëpia, i dërgon SMS, nga telefoni me nr....., nënës së vetë, H.M, duke i shkruar „qitni 3000 (tri mijë) Euro, ta kthejmë qiken gjallë.‘’, menjëherë pasi që kishte pranuar mesazhin nëna e saj provon ta kontakton të pandehurën në telefon, por e njëjta nuk i përgjigjet, dhe e lajmëron rastin në polici.

- me çka ka kryer veprën penale *lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 390 par.4 të KPRK-së*.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 23 par. 1 dhe 3, 85, 86 par. 1 dhe 2 dhe 390 par 4 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par. 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 të KPPRK-së, të pandehurës i shqipton

VËREJTJE GJYQËSORE

Të pandehurës i bëhet me dije se ka kryer veprë penale të dëmshme dhe nëse sërish kryen ndonjë veprë të tillë, gjykata do të shqiptoi sanksionin penal.

E pandehura obligohet që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzetë) euro, dhe shumë prej 30 (tridhjetë) euro në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Peje – Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.II.nr.101/16 të dt.08.03.2016, kundër të pandehurës A. M, nga P., e akuzuar për veprën penale *lajmërimi apo kallëzimi i rremë, nga neni 390 par.4 të KPRK-së*.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 07.02.2018 në praninë e Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurës A. M. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit e pandehura u deklarua fajtores për veprën penale me të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të pandehurës dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se e pandehura pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, e pandehura është d vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurës se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresa të lëndës e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të

pandehurës A. M, nga Peja, e akuzuar për veprën penale *lajmërimi apo kallëzimi i rremë*, nga neni 390 par.4 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se e pandehura e ka kryer veprën nga pakujdesia, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata ka vlerësuar faktin se e njëjta ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier e përgjegjshme për veprime e saj dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Gjithashtu e pandehura asnjëherë nuk ka qenë e dënuar me herët për ndonjë vepër penale. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të pandehurit. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të pandehurën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se vërejtja gjyqësore e shqiptuar ndaj të pandehurës është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vërejtja gjyqësore do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzetë) euro, dhe shumën prej 30 (tridhjetë) euro në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.216/16 me datë 07.02.2018.

Sekretarja Juridike
Lindmire Begolli

G j y q t a r i

Ahmet Rexhaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.